

VENDIM
Nr. 640, datë 27.8.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 667, DATË 29.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 4, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 667, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, para akronimit “DPA” shtohen fjalët “... në vijim ...”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe selia e saj ndodhet në Tiranë.”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit operon në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, rregulloret, udhëzuesit dhe kërkesat për akreditim.”.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. DPA-ja ka detyrim plotësimin në mënyrë të vazhdueshme të kërkesave të neneve 9, 10 dhe 11, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë. Drejtori i përgjithshëm asistohet dhe mbështetet nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm për përmbushjen e objektivave të institucionit, duke bashkërenduar dhe mbikëqyrur veprimtari dhe funksione të veçanta të strukturave të DPA-së, përcaktuar me urdhër dhe delegim të drejtorit të përgjithshëm, si dhe në rregulloren e brendshme. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm kryen, gjithashtu, detyrat e menaxherit të cilësisë, sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17011:2017 “Vlerësimi i konformitetit – Kërkesat për organizmat e akreditimit që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit”.”.

5. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. DPA-ja dërgon në ministri, deri në datën 31 janar të çdo viti kalendarik:

a) raportin vjetor të DPA-së dhe objektivat për vitin pasardhës;

b) raportin vjetor të Bordit të Akreditimit;

c) raportin në lidhje me ankesat dhe apelimet;

ç) raportin në lidhje me shkallën e kënaqësisë së klientëve.

Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të DPA-së brenda 10 ditëve nga miratimi.”.

6. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Organet e vlerësimit të konformitetit, të regjistruara në Shqipëri dhe të akredituara nga organizma akreditues të huaj, informojnë DPA-në brenda 30 ditëve kalendarike për marrjen e akreditimit të tyre dhe deri më 31 janar të çdo viti për statusin e tyre të akreditimit.”.

7. Në pikën 18, fjalët “... në pikën 15 ...” zëvendësohen me “... në pikën 17 ...”.

8. Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. DPA-ja ka logon dhe simbolin e saj të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. DPA-ja i jep të drejtën organeve të akredituara prej saj të përdorin

simbolin e akreditimit. Simboli i akreditimit përbëhet nga logoja e DPA-së, standardi kundrejt të cilit janë akredituar, vlerësimi i konformitetit dhe numri i akreditimit. DPA-ja publikon rregullat e përdorimit të simbolit të akreditimit në faqen zyrtare të saj.”.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi